

VENDIM
Nr. 34, datë 9.3.2016

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
“RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË ASETVE NGA TË
LICENCUARIT”

Në mbështetje të neneve 16, 44, pika 2 dhe 108, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe neneve 29, pika 2, 116, pika 4, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe nenit 26, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me “Rregulloren e procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”,

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti